



PORTOFOLI I TË NXËNIT, INSTRUMENT PËR ZHVILLIMIN DHE VLERËSIMIN E KOMPETENCAVE TË NXËNËSVE

Udhëzues në ndihmë të shkollave dhe të mësuesve
të arsimit të mesëm të lartë

“19



FINANCUAR NGA

 **Federal Ministry**
Education, Science
and Research



PORTOFOLI I TË NXËNIT, INSTRUMENT PËR ZHVILLIMIN DHE VLERËSIMIN E KOMPETENCAVE TË NXËNËSVE

Hartuar në bashkëpunim me mësues, drejtues shkollash, specialistë të DAR/ZA
dhe ekspertë në fushën e edukimit

Nën kujdesin e
Ministrit të Arsimit
Sportit dhe Rinisë



Koordinuar nga
Instituti i Zhvillimit
të Arsimit



Grupi i punës:

Dr. Mirela Andoni

Dr. Dorina Rapti

Evis Mastori

Ines Todhe

Erida Koleci

Design dhe Layout: **Elton Rama, Tiranë**

Printimi: **Deaprint, Tiranë**

Botimi i parë: **2019**

Copyright: **KulturKontakt Austria**

Në përputhje me synimet e projektit të implementuar nga KulturKontakt Austria, materialet e këtij botimi mund të përdoren vetëm në mësim dhe për qëllime jokomerciale.

Ky material është hartuar në kuadër të projektit "Portofoli i të nxënësve, instrument për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave të nxënësve", i financuar nga Ministria e Arsimit në Austri dhe i zbatuar nga KulturKontakt Austria.

Adresa:

KulturKontakt Austria, Regional Project Office Tirana,
Rruga Naim Frashëri, 37, Tirana

Financuar nga Ministria
Arsimit në Austri

 **Federal Ministry**
Education, Science
and Research

Hyrje

Udhëzuesi “Portofoli i të nxënit, instrument për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave të nxënësve” u realizua në kuadër të projektit “Portofoli i të nxënit, instrument për të mbështetur dhe matur arritjet e të nxënit bazuar në kompetenca në arsimin parauniversitar”. Ky projekt u zbatua në periudhën 2014-2018, nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, koordinuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), konceptuar nga KulturKontakt, Austri dhe “Qendra për Aftësi Konkurruese” dhe financuar nga ministria Austriake e Arsimit.

Udhëzuesi është produkt i një procesi të gjatë takimesh, diskutimesh dhe workshop-esh, proces në të cilin u përfshinë 78 mësues të arsimit të mesëm të ulët nga 26 shkollat pilot nga i gjithë vendi, si dhe 178 mësues dhe drejtues të shkollave të arsimit të mesëm të lartë si dhe specialistë të DAR dhe ZA.

Qëllimi i këtyre veprimtarive u fokusua në zhvillimin dhe vlerësimin e portofolit të të nxënit në arsimin parauniversitar për dokumentimin e arritjeve të nxënësve dhe sigurimin e cilësisë në procesin e zbatimit të kurrikulës bazuar në kompetenca

Falenderojmë **KulturKontakt Austria** për mbështetjen e kësaj iniciative.

Një falenderim të veçantë për mësuesit, drejtuesit e institucioneve arsimore, specialistët që me sugjerimet e tyre kontribuan në përgatitjen e këtij udhëzuesi.

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I UDHËZUESIT	06
2.KUPTIMI DHE RËNDËSIA E PORTOFOLIT TË TË NXËNIT	07
2.1. Portofoli si komponent i rëndësishëm i vlerësimit në një kurrikul me bazë kompetencat _	07
2.2. Portofoli dhe procesi i të nxënit	12
3. STRUKTURA E PORTOFOLIT TË TË NXËNIT DHE PLANIFIKIMI I DETYRAVE	14
3.1. Projekti kurrikular si pjesë e detyruar e portofolit	15
4. VLERËSIMI I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT	18
4.1 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri – tjetri	22
5. MODELE/SHEMBUJ TË PORTOFOLAVE TË TË NXËNIT SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT	27
6. LITERATURA	55

01

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi **“Portofoli i të nxënit, instrument për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave të nxënësve”** është një material ndihmës për përdoruesit e kurrikulës dhe në mënyrë të veçantë për mësuesit, drejtuesit e gjimnazeve dhe specialistët e DAR/ZA-ve për vlerësimin e nxënësve bazuar në portofolin e të nxënit. Nëpërmjet këtij udhëzuesi parashtrohet rëndësia, përmbajtja dhe procedurat që duhen mbajtur parasysh për planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e portofolit të të nxënit.

Përmes portofolit të të nxënit mësuesi i drejton nxënësit në koleksionimin e rezultateve/ arritjeve të të nxënit sipas një rendi të mirëstrukturuar, me qëllim vlerësimin, vetëvlerësimin dhe shkëmbimin e këtyre arritjeve.

Udhëzuesi ka si qëllim:

- Të ndihmojë mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit për kuptimin e portofolit të të nxënit si një instrument që nxit dhe mbështet zhvillimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës.
- Të mbështesë mësuesit në procesin e planifikimit të detyrave dhe veprimtarive të portofolit, në përmbushje të realizimit të rezultateve të të nxënit të kompetencave.
- Të ofrojë rekomandime dhe mbështetje për planifikimin dhe vlerësimin e projekteve kurrikulare si pjesë e detyruar e portofolit të të nxënit.
- Të tregojë rrugën dhe procesin e vlerësimit të detyrave të portofolit bazuar në kritere, përmes përdorimit të niveleve të arritjeve të nxënësve.
- Të ofrojë modele dhe shembuj të planifikimeve dhe vlerësimit të portofolave të të nxënit për fusha të ndryshme të të nxënit në arsimin e mesëm të lartë.

02

KUPTIMI DHE RËNDËSIA E PORTOFOLIT TË TË NXËNIT


2.1. Portofoli si komponent i rëndësishëm i vlerësimit në një kurrikul me bazë kompetencat

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).

Duke iu referuar qasjes së re kurrikulare, portofoli i të nxënit zë një vend të posaçëm pasi:

- mbështet zbatimin e kurrikulës bazuar në kompetenca;
- krijon qëndrueshmëri **në procesin e realizimit të saj**;
- ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e cilësisë **së zbatimit të kurrikulës dhe të arritjes së të nxënit**.

Në këtë kontekst ka vend përkujdesja për **të unifikuar kuptimin mbi mënyrën** si do të menaxhohet ky proces dhe produkt nga mësuesi.




Kurrikula e re e arsimit të mesëm të lartë ka në themel të saj krijimin e kompetencave të nxënësi; si rrjedhojë procesi i realizimit dhe i dokumentimit të të nxënësit duhet të bazohet në atë çfarë nxënësi arrin të performojë.

Përgjithësisht **kompetenca është “aftësia e individit për të demonstruar përmbushjen e një detyre në një kontekst të dhënë”**. Për shembull, të zotërosh kompetencën e përdorimit të programit “Word” në kompjuter, do të thotë të jesh i aftë të demonstrosh shkrimin e teksteve, ndërtimin e skemave dhe kryerjen e operacioneve të tjera në kuadrin e programit “Word” të kompjuterit.

Në arsim, kemi të bëjmë më shumë me kompetenca që tregojnë aftësinë e nxënësit për të demonstruar përmbushjen me sukses (brenda disa kriterëve) të një detyre të caktuar, në një kontekst të dhënë.

Nga ky përkufizim, mund të themi se



KOMPETENCA formulohet si tërësia e njohurive, e aftësive dhe e qëndrimeve që demonstرون një individ gjatë përmbushjes së detyrave të kërkuara në kushte të caktuara.

Këto tre elemente përbërëse të kompetencave ndërthuren dhe integrohen me njëra-tjetrën, duke krijuar të nxënësi kompetenca të plota dhe të qëndrueshme.

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, të shkathtësive, të vlerave dhe të qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit.

Kompetencat mund të jenë **të gjera** (p.sh., aftësia për të komunikuar) ose **të ngushta** (p.sh., aftësia për të shumëzuar numrat). Ato mund të jenë **të përgjithshme** (p.sh., aftësia për të planifikuar) ose **të veçanta** (p.sh., aftësia për të kryer mbledhje dhe zbritje të numrave).

Në arsimin e mesëm të lartë kurrikula mundëson:

- a. Zhvillimin e **kompetencave kyçe/të përgjithshme**, ku më kryesoret janë aftësitë për të komunikuar, për të kryer llogaritje matematike, për të përdorur teknologjinë e informacionit, për të nxënë, për të planifikuar, për të ndërmarrë nisma, për të zgjidhur problemet jetësore etj., që ndihmojnë çdo individ për të përballuar sfidat e jetës, pavarësisht nga veprimtaria profesionale që ushtron.
- b. **Kompetencat e fushës/lëndës** të cilat u referohen aftësive të lidhura ngushtësisht me aspekte shkencore të materies përkatëse.

Nevojat për ndryshime arsimore e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Të rinjtë të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimit do t'i mundësojë çdo nxënës zotërimin e kompetencave kyçe, të nevojshme për jetën dhe punën.

Rrugët dhe mënyrat me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe shërbimeve ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja, të cilat i ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme digjitale jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike, por edhe nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, të sfidave dhe të çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore, që lindin ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike. Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave, që i aftësojnë individët të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

- Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:
- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.
- Kompetenca e të menduarit.
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.
- Kompetenca personale.
- Kompetenca qytetare.
- Kompetenca digjitale.

Tri kompetencat e para kanë natyrë instrumentale. Ato janë bazë për kompetencat e tjera, që janë më tepër të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën personale, publike dhe profesionale.

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

Që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë personalitetin, të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë mesazhet që u drejtohen dhe të shprehën në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për t'u bërë komunikues efektivë, nxënësit ndihmohen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

Marrja dhe përpunimi i njohurive në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Nxënësit kanë nevojë jo vetëm të marrin informacion, por edhe të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.

3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë (nxënësi mëson për të nxënë)

Në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji dhe në ekonomi nuk mund të kërkohej që të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Shkolla u krijon nxënësve të gjitha kushtet dhe mundësitë për t'u arsimuar dhe për t'u përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës. Ajo i ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kultivojnë kureshtjen dhe interesin për dije dhe të zhvillojnë kompetencën për të nxënë. Në funksion të kësaj kompetence, shkolla duhet të ndërgjegjësohet për rëndësinë e strategjive të efektshme të të nxënit.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

Shkollat i përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla u krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvlerësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, duke i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.

5. Kompetenca personale (nxënësi bën jetë të shëndetshme)

Për të zhvilluar kompetencën personale, shkollat i përgatisin nxënësit të përfshihen në mënyrë efektive në jetën familjare, shoqërore dhe në punë. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen të ndërgjegjësohen për veten dhe të kenë vetëbesim, si dhe të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe së nesërme. Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

7. Kompetenca digjitale (nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Kompetenca digjitale nënkupton përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë, gjatë kohës së lirë dhe gjatë komunikimit. Ajo mbështetet në shkathtësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, për të prodhuar, për të krijuar, për të prezantuar dhe për të shkëmbyer informacione si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet.


Ashtu si njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet integrohen te kompetenca, edhe kompetencat e ndryshme ndërthuren me njëra - tjetrën dhe krijojnë atë që quhet *formim i nxënësit*.

Në procesin mësimor kompetencat (*kyçe dhe të lëndës*) realizohen të integruara.

Në procesin e planifikimit, realizimit dhe reflektimit/vlerësimit, mësuesi mban parasysh përmbushjen e të gjitha këtyre kompetencave nga nxënësi.

Kjo është arsyeja e rëndësishë që merr portofoli si një mjet për të dokumentuar, për të treguar, për të krahasuar dhe për të vlerësuar mbërritjen të qëllimi i artikuluar në kurrikul.

Në kurrikulën e bazuar në kompetenca, është detyrim *vlerësimi* dhe *monitorimi i vazhdueshëm i arritjeve të nxënësve*, duke iu referuar rezultateve të të nxënësit të kompetencave (njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve).



Rezultatet e të nxënësit dhe përmbushja e tyre përmes detyrave të portofolit

Rezultatet e të nxënësit janë pohime që përshkruajnë se çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë nxënësit për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve.

Rezultatet e të nxënësit të detyrave që përfshin portofoli i të nxënësit hartohen mbi bazën e *rezultateve të të nxënësit të kompetencave kyçe dhe të lëndës, të përcaktuara në programin mësimor të lëndës*. Mësuesi përcakton në fillim të periudhës rezultatet e të nxënësit për secilën prej detyrave që do të zhvillojë përmes portofolit. Këto rezultate duhet të specifikohen me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për nxënësit, në mënyrë që ata të përqendrohen në atë se çfarë duhet të arrijnë (qëllimin) përmes zhvillimit të detyrave.

Nëse u bëhet e qartë nxënësve se cili është **qëllimi i të nxënit** dhe cili është **konteksti**, ata janë në gjendje t'i transformojnë aftësitë e tyre (edhe nëse ndryshohet konteksti).

Rezultatet e të nxënit duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit.

2.2. Portofoli dhe procesi i të nxënit

Vëmendja e shkollës bashkëkohore sa vjen e drejtohet me përparësi te përgjegjësitë që duhet të marrin nxënësit gjatë procesit të të nxënit. Nga këndvështrimi i të nxënit, ta vështrosh nxënësin si një arkitekt të të nxënit të vet është një praktikë e të mësuarit e cila kërkon që t'i nxisim nxënësit për t'u kthyer në ndërtues të dijeve të veta.

Të nxënit aktiv, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese realizohet suksesshëm sidomos nëpërmjet zhvillimit të detyrave komplekse dhe afatgjata që përfshin portofoli i të nxënit, të cilat mundësojnë kërkimin, punën e pavarur, punën në grup, zgjidhjen e problemit, marrjen e vendimeve etj.

Qasja me portofol u jep përgjigje pyetjeve:

- Pse duhet të dokumentohen kompetencat e arritura nga nxënësit në arsimin e mesëm të lartë?
- Sa ndikon dokumentimi dhe koleksionimi i arritjeve për njohjen dhe orientimin e mëtijshëm të nxënësve për studim dhe punësim?
- Si edukon portofoli vetëdijësimin **e nxënësve dhe prindërve për nivelin e kompetencave, talentet, prirjet e tyre** etj. si dhe mundësinë për t'i bërë të transferueshme dhe të adoptueshme kompetencat e fituara në sisteme të tjera arsimore?

Procesi i krijimit të portofolit përmirëson mundësitë për një mënyrë të re të të nxënit. Gjatë procesit tradicional të të nxënit, zakonisht synohet memorizimi i fakteve apo informacioneve. Përdorimi i portofolit si instrument për zhvillimin e kompetencave ndikon në *një të nxënë të thellë*, duke krijuar mundësi për të integruar njohuritë e mëparshme dhe për të *konsideruar të nxënit e mëparshëm* në situata të ndryshme.

Si pjesë e këtij procesi, nxënësi inkurajohet të shohë mbi detajet e njohjes. Përmes realizimit dhe dokumentimit të detyrave përfshihen shumë aftësi të akumuluar, duke e bërë nxënësin të ketë një këndvështrim më të gjerë.

Në thelb, portofoli, me dokumentacionin që e përbën, argumenton përgjegjësitë e mësuesit për mësimdhënien dhe të nxënit.

NDRYSHIME POZITIVE QË SJELL VLERËSIMI PËRMES PORTOFOLIT TË TË NXËNIT

PËR NXËNËSIT:

- Nxiti reflektimin e tyre për procesin e të nxënit.
- Bën të marrin përgjegjësi për të nxënit e tyre.
- Siguron vetëbesim te nxënësit. Ata mund të ndjehen të suksesshëm.
- Krijon mundësi për vetëvlerësim dhe forma të larmishme vlerësimi.
- Bazohet në nivele arritjesh të njëjta për të gjithë.
- Siguron gjykime dhe mbështet vendimmarrje mbi bazën e të dhënave të shumta që siguron.
- Zhvillon talente dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të tregojnë arritjet e tyre.
- I bën nxënësit më miqësorë me lëndën.

PËR MËSUESIT:

- Siguron të dhëna të hollësishme për aspekte të ndryshme të të nxënit.
- Krijon mundësi të gjykojnë më mirë arritjet e nxënësve.
- Krijon mundësi që të ndërtojnë veprimtari, të cilat zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik, krijues, pavarësinë në kryerjen e detyrave, bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis nxënësve, gjithëpërfshirjen etj.
- Nxiti rritjen profesionale të mësuesit.
- Krijon mundësi që nxënësit të informohen në mënyrë të vazhdueshme për progresin e tyre, pikat e forta dhe të dobëta, në mënyrë që të ndihmohen për t'u përmirësuar.
- Siguron informacion të hollësishëm dhe specifik për arritjet e fëmijës.

PËR PRINDËRIT:

- Siguron informacion të hollësishëm dhe specifik për arritjet e fëmijës.
- I përfshin në procesin e të nxënit të fëmijës.
- U krijon mundësi për mbështetje.



STRUKTURA E PORTOFOLIT TË TË NXËNIT DHE PLANIFIKIMI I DETYRAVE

Për të udhëhequr një portofol efektiv të të nxënës, mësuesi duhet të mbështetet në tri ide bazë:

- Zhvillimi/plotësimi i portofolit duhet të **udhëhiqet nga funksioni që ka** në zbatimin e kurrikulës me kompetenca;
- Detyrat dhe menaxhimi i portofolit duhet të marrë parasysh **moshën e nxënësit**;
- Portofoli duhet të **nxjerrë në pah procesin e të nxënës** nëpërmjet të dhënave dhe dokumenteve të ndryshme që nxënësi koleksionon (mbledh) dhe që mbështetin reflektimin e tij për të nxënës.

Mësuesi duhet të jetë transparent me nxënësin në lidhje me detyrat e portofolit, materialet dhe peshat për vlerësimin e tij. Ai i udhëzon nxënësin në mënyrë të vazhdueshme për krijimin dhe zhvillimin e portofolit.

Përcaktimi i detyrave buron nga funksioni që ka portofoli për të nxënës dhe procesin e vlerësimit. Pra, **të vihet theksi në elemente që nuk mund të vlerësohen përgjatë vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse.**

Lind pyetja: Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e detyrave të portofolit?

- Në fillim të periudhës, mësuesi së bashku me nxënësin përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në përmbushje të rezultateve të të nxënës.
- Mësuesi gjykon i pavarur për peshën e çdo detyre të portofolit për vlerësim.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe u prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë.
- Mësuesi i udhëzon nxënësin për krijimin dhe zhvillimin e portofolit si dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij.
- Mësuesi monitoron përgjatë gjithë periudhës zhvillimin e detyrave të portofolit.

Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra/punë hulumtuese/projekte të nxënësve që tregojnë **kompetencat apo rezultatet e të nxënës** për t'u arritur nga nxënësin.

Për një periudhë, portofoli duhet të përmbajë minimalisht dy – tri detyra (duke përfshirë projektin kurrikular).

- **Projekti ose një fazë e tij është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.**
- **1 – 2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.**

Detyrat e portofolit duhet të jenë të njëjta për çdo nxënës. Ato mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, si dhe me karakter hulumtues dhe krijues të tilla, si:

- punë praktike,
- ese argumentuese/përshkruese,

- punime me shkrim,
- punime audio - vizuale,
- guida,
- albume,
- aktivitete në grup ose individuale,
- projekte individuale ose në grup,
- etj.

Kujdes! Detyrat NUK duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.

3.1. Projekti kurrikular si pjesë e detyruar e portofolit

Projekti kurrikular është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënës. Ai është strategji e të nxënës dhe e mësimdhënies me në qendër nxënësin, përmes të cilit ata në mënyrë të pavarur ose/dhe si anëtarë të një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti, si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK-ut, të sipërmarrjes etj.

Në planifikimin e projektit mësuesi duhet të ketë parasysh kohën e mjaftueshme që duhet të lërë në dispozicion të orëve të projektit, në mënyrë që t'u japë mundësi nxënësve të kryejnë kërkimin gjeografik dhe të zhvillojnë detyra kërkuese dhe krijuese.

Zbatimi i një projekti kurrikular kërkon të paktën tri orë mësimore. Mësuesi, që kur planifikon projektin, duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit; mësuesi i monitoron dhe i vlerëson nxënësit edhe gjatë zhvillimit të tij.

Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe, vlerësohet i gjithë projekti.

Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë të efektshme i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë dhe me hollësi detyrën mësimore për çdo grup dhe nxënë (është mjaft e rëndësishme që secili nxënë të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënës që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; t'i qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit si dhe për kriteret e vlerësimit të tij; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme.

Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vërtetimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale etj.

Fazat kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktohet saktë çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.

- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen, për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e çdo nxënësi.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose paraqitet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit do t'i renditim më poshtë. Mësuesi mund ta pasurojë planin me rubrika të tjera, në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij. Ai përfshin në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit, sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Në rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshihen:

- **Tema e projektit** (përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit).
- **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore** (nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- **Klasa/Klasat pjesëmarrëse** (përcaktohet klasa ose klasat nëse ka disa të tilla).
- **Rezultatet e të nxënit** (përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit).
- **Njohuritë kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit** (përcaktohen njohuritë që duhet të zhvillojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- **Partnerët** (nëse ka, p.sh., nëse projekti në lëndën e gjeografisë ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për ndotjen mjedisore në zonën ku banojnë, një specialist i mjedisit mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt).
- **Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.**
- **Burimet kryesore të informacionit** (mësuesi duhet t'i orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit).
- **Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor** (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit; p.sh., nëse projekti planifikohet në 5 orë, atëherë duhet vendosur tematika për të pesë orët).
- **Përshkrimi i produktit të projektit** (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- **Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi** (mësuesi përcakton kriteret për vlerësimin e projektit, të cilat ia komunikon nxënësit qysh në fillim të projektit; p.sh., mund të përcaktohen kriteret për trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënit).

Shembuj kriteresh për vlerësimin e projektit:

A është e fokusuar përmbajtja e projektit te çështja/problemi i identifikuar për shqyrtim?

A është e lidhur tema e projektit me situata nga jeta reale?

A i kanë zbatuar nxënësit konceptet e marra në lëndën përkatëse?

A kanë mbledhur nxënësit të dhëna bazuar në burime të mjaftueshme informacioni?

A kanë bashkëpunuar nxënësit për të zhvilluar aftësitë komunikuese, vetëmenaxhuese dhe organizuese?

Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënësit bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësit e drejtuar prej tyre.



VLERËSIMI I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT

Nisur nga fakti se materialet në portofol janë mbledhur gjatë një periudhe të caktuar kohe, vlerësimi i progresit të nxënësit përmes portofolit siguron të dhëna që pak teknika të tjera mund t'i ofrojnë.

Detyrat e portofolit monitorohen dhe vlerësohen përgjatë periudhës përkatëse kur ato dorëzohen dhe nuk lihen për në fund kur vlerësohet i gjithë portofoli.

Reflektimet e mësuesit

Monitorimi dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve për detyrat e portofolit përgjatë periudhës mund të konsiderohet si një dialog ndërmjet mësuesit dhe nxënësit për cilësinë e të nxënës, mësimdhënies dhe arritjeve në përgjithësi. Ky komunikim i dyanshëm siguron një informacion që mundëson identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë realizimit të detyrave, si dhe zbulimin e shkaqeve të cilat i sjellin ato vështirësi.

Refleksionet e mësuesit janë një pjesë shumë e rëndësishme e të nxënës. Ato janë mekanizma që u lejojnë nxënësve të dinë nëse janë në rrugën e duhur.

Reflektimet e mësuesit gjatë vlerësimit të detyrave e ndihmojnë nxënësin të kuptojë rezultatin si dhe ku duhet të punojë për ta përmirësuar atë.

Reflektimet e mësuesit:

- duhet të jenë konstruktive, në mënyrë që nxënësit të ndjehen të inkurajuar dhe të motivuar për t'u përmirësuar;
- të jepen në kohën e duhur dhe jo vetëm në fund të detyrës, në mënyrë që nxënësit t'i përdorin ato për të përmirësuar punën;
- të jenë të fokusuara në arritjet dhe përpjekjet specifike të nxënësit, pasi në këtë mënyrë ata sigurojnë informacion të dobishëm për to.

Refleksionet e mësuesit mund të jepen me gojë ose me shkrim. Ato duhen të jepen kundrejt kritereve të vlerësimit dhe qëllimit të të nxënës.

Të jesh i motivuar dhe të kesh vetëbesim janë çelësi i suksesit të nxënësit. Megjithatë, refleksionet e mësuesit përveç gjërave pozitive, duhet t'i tregojnë nxënësit edhe gabimet (në mënyrë që ato të përmirësohen).

Kriteret e vlerësimit

Teksa rezultatet e të nxënës shërbejnë për të kuptuar 'çfarë' dhe 'pse' po mësojmë, kriteret e vlerësimit na orientojnë të kuptojmë sa kemi nxënë apo kemi qenë të suksesshëm. Kriteret i japin përgjigje të njëjtës pyetje edhe nga këndvështrimi i nxënësit: *Si do ta di nëse i kam realizuar qëllimet e të nxënës?*

Përdorimi i kriterëve për vlerësimin e detyrave të portofolit ka ndikim të dukshëm si në mësimdhënie, ashtu edhe në nxënie, kryesisht te nxënësit të cilëve u mundësohet ta vlerësojnë veten apo dhe shokët ose shoqet e tyre.

Kriteret janë të lidhura ngushtë me qëllimet e të nxënit, janë hapat për të arritur deri te qëllimi.

Mësuesit mund t'i hartojnë kriteret e vlerësimit në bashkëpunim me nxënësit.

- *E rëndësishme është që si rezultatet e të nxënit, ashtu edhe kriteret e vlerësimit të diskutohen së bashku me nxënësit, në mënyrë që ata të përqendrohen tek ato gjatë gjithë punës së tyre.*
- *Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që vendos mësuesi.*
- *Kriteret përcaktohen në varësi të llojit të detyrës, duke iu referuar niveleve të arritjeve.*
- *Kriteret e vlerësimit mësuesi duhet t'ua komunikojë nxënësve që në fillim të periudhës.*

Kriteret shërbejnë si bazë e vlerësimit të punës së nxënësve si nga mësuesit, ashtu edhe nga vetë nxënësit. Me paraqitjen e kriterëve nxënësit do ta vlerësojnë punën e tyre apo të njëri – tjetrit në mënyrë korrekte dhe të drejtë, duke mos vlerësuar elementet të cilat nuk kanë qenë kriteret e arritjeve. Po ashtu kriteret shërbejnë për një punë të pavarur të nxënësve, duke u mbështetur te këto kriteret dhe jo te shoku/shoqja apo mësuesi. Kjo është një vlerë e cila do t'u shërbejë atyre edhe në jetën e përditshme.

Gjatë përcaktimit të kriterëve duhet pasur kujdes të theksohet procesi dhe karakteristikat dhe jo vetëm produkti final.

Kriteret duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit. Diferencimi dhe mbështetja për nxënës me nevoja të ndryshme bëhet nëpërmjet aktiviteteve.

Më poshtë po japim një shembull kriteresh për vlerësimin e një projekti kurrikular me shtrirje gjithëvjetore.

Periudha	Kriteri	Niveli 2
Periudha 1	Strukturon pyetësorët/intervistat në përmbushje të tematikës dhe mbledhjes së të dhënave.	Formulon pyetje të cilat nuk e adresojnë problemin konkret dhe grumbullimin e të dhënave.
		(2 pikë)
	Identifikon dhe përdor burime të larmishme për hulumtimin e informacionit.	Përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit.
		(2 pikë)
	Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup.	I bashkohet grupit, por nuk është aktiv në realizimin e detyrës.
		(1 pikë)
Totali		
Periudha 2	Përpunon informacionin e mbledhur bazuar në të dhëna.	Identifikon informacionin dhe të dhënat për të nxjerrë përfundime të thjeshta.
		(2 pikë)
	Organizon draft-produktin në përmbushje të tematikës dhe zgjidhjes së problemit.	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin, por nuk ofrojnë zgjidhje.
		(2 pikë)
	Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup. (2 pikë)	I bashkohet grupit, por nuk është aktiv në realizimin e detyrës.
		(1 pikë)
Totali		
Periudha 3	Trajton tematikën në funksion të zgjidhjes së problemit.	Identifikon zgjidhje për çështjen aktuale pa u thelluar në pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.
		(2 pikë)
	Paraqet informacionin, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.	Organizon me vështirësi informacionin, pa e përshtatur për audiencën e synuar.
		(2 pikë)
	Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup për prezantimin e produktit përfundimtar.	I bashkohet grupit, por nuk është aktiv në realizimin e detyrës.
		(1 pikë)
Totali		

Niveli 3	Niveli 4
Formulon pyetje që e adresojnë pjesërisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave.	Formulon pyetje që e adresojnë tërësisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave.
(4 pikë)	(6 pikë)
Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit pa vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit, duke vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
(4 pikë)	(6 pikë)
Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë.	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët.
(2 pikë)	(3 pikë)
15 pikë	
Përkrah informacionin dhe të dhënat për të nxjerrë përfundime duke u bazuar në të dhëna.	Analizon dhe interpreton informacionin dhe të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe për të vënë në pah kufizimet.
(4 pikë)	(6 pikë)
Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje të pjesshme.	Strukturon raportin në çështje që adresojnë tërësisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje.
(4 pikë)	(6 pikë)
Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë.	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët.
(2 pikë)	(3 pikë)
15 pikë	
Propozon zgjidhje për çështjen aktuale dhe identifikon disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.	Propozon zgjidhje për çështjen aktuale dhe analizon pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.
(4 pikë)	(6 pikë)
Organizon informacionin, pa e përshtatur atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor fjalorin dhe terminologjinë.	Organizon informacionin, e përshtat atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor fjalorin dhe terminologjinë e lëndës.
(4 pikë)	(6 pikë)
Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë.	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët.
(2 pikë)	(3 pikë)
15 pikë	

Për vlerësimin e përgjithshëm të detyrave të portofolit për një periudhë të caktuar, mësuesi përcakton peshat në pikë ose në përqindje për secilën detyrë.

Shembull

Periudha I (shtator – dhjetor). Për secilën detyrë mësuesi ka përcaktuar pikët ose peshat në përqindje: p.sh., nxënësi X, duke vlerësuar përmbyshjen e kritereve për detyrën e parë, ka marrë 8 pikë, ndërkohë që totali i pikëve për këtë detyrë është 15 pikë.

Ndarja e pikëve sipas detyrave të përcaktuara

Detyra	Detyra 1 (15 pikë)	Detyra 2 (5 pikë)	Detyra 3 (10 pikë)	Portofoli (gjithsej)
Pikë	8	3	7	18

Vlerësimi i portofolit me notë sipas pikëve të vendosura

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 7	8 - 11	12 - 15	16 - 19	20 - 23	24 - 27	28 - 30

Në këtë rast nxënësi vlerësohet me notën 7 për portofolin.

Vlerësimi dhe prezantimi i portofolit të nxënësit

- Vlerësimi i portofolit mund të parashikohet si orë e veçantë në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tre – katër orëve të fundit të periudhës. Nxënësi sugjerohet të prezantojë punimet e grumbulluara në portofol duke u fokusuar te llojshmëria e detyrave, proceduar e ndjekur për përmbyshjen e tyre.
- Në rastet kur vlerësimi i portofolit nuk përcaktohet si orë e veçantë, mësuesi cakton sipas ditëve një grafik të nxënësve të cilëve do t'u vlerësohet portofoli.

4.1. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri - tjetri i nxit ata të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme.

Vetëvlerësimi

Nxitja e nxënësit për t'u përfshirë në vendosjen e kritereve për vlerësimin e punës së tij bën që një pjesë e përgjegjësisë të kalojë te nxënësi. Kjo ndjeshmëri e përdorur me më shumë theks te zhvillimi i nxënësit dhe vetëkuptimi, krahasuar thjesht me qëllimin për të arritur te një notë, bën që vetëvlerësimi të kontribuojë në mundësitë e nxënësit për të strukturuar procesin e tij të të nxënësit. Kjo rrit më tej zotërimin e procesit të nxënies nga nxënësit.

Gjatë procesit të vetëvlerësimit, nxënësit duhet të dinë:

- Të analizojnë punën e tyre.

- Të kërkojnë mbështetje kur hasin vështirësi gjatë punës.
- Të shfrytëzojnë kohën e mjaftueshme **për t'i përmirësuar**/për t'i zgjidhur detyrat/problemet e pazgjidhura.

Teknika për vetëvlerësimin

1. Ngjyrat e semaforit është një teknikë shumë efikase, që i mundëson nxënësit të reflektojnë për veten, nëse ka kuptuar ose jo një çështje/detyrë apo temë të caktuar. Në të njëjtën kohë, secili prej nxënësve, në mënyrë individuale, i komunikon mësuesit të kuptuarit ose jo të teknikës.

Nxënësit mbajnë tri letra (kartonë) me ngjyra të ndryshme para vetes, të cilat pasqyrojnë:

- e gjelbra – e kam kuptuar,
- e verdha – nuk jam i sigurt,
- e kuqja – nuk e kam kuptuar.

Kur u kërkohet nga mësuesi, nxënësit ngrenë lart njërin prej letrave. Kjo teknikë përdoret në faza të ndryshme të orës së mësimi dhe jo vetëm në fund të saj.

Kur mësuesi e merr informacionin nga nxënësit, atëherë është më i sigurt në planifikimin e aktiviteteve të tjera shtesë për ata që nuk e kanë kuptuar detyrën (ose u kërkon të bashkëpunojnë me nxënësit që e kanë të qartë/e kanë kuptuar detyrën);

Në vend të letrave (kartonëve) me ngjyra mund të përdoren edhe shenja tjera, si: fytyra të buzëqeshura/të pikëlluara ose numrat 1, 2, 3.

2. Krijimi dhe përdorimi i rubrikave të pikëve

- Hapi i parë: nxënësit përfundojnë **një detyrë** si, p.sh., një punim artistik apo një projekt;
- Mësuesi dhe nxënësit krijojnë së bashku një rubrikë pikësh;
- Nxënësit punojnë në grupe ose në çifte për ta përdorur rubrikën e pikëve për detyrën e përfunduar;
- Nxënësit i raportojnë klasës se çfarë kanë mësuar nga përdorimi i rubrikës.

Shembull: Vetëvlerësimi me pyetje mbi esetë (Shënoni me X kriteret e përshtatshme.)

Formulime mbi situatën para shkrimit:

- _____ A i kam lexuar me kujdes pyetjet?
- _____ A i kam nënvizuar fjalët dhe shprehjet kryesore?
- _____ A kam ndërtuar një skicë që përfshin fjalët kyçe dhe idenë kryesore?

Ese

A. Hyrje

- _____ A jam i sigurt se e kam ndërthurur çështjen e trajtuar nga kjo ese në paragrafin hyrës?
- _____ A e kam shtjelluar temën dhe pikëpamjen time në një mënyrë të qartë?

B. Trupi i esesë

- _____ A ka lidhje secili nga paragrafët me hyrjen?
- _____ A shtjellohen në ese idetë apo detajet e mia të përmendura në hyrje?
- _____ A kam prova të mjaftueshme për të mbështetur arsyetimin tim?

C. Përfundimi

- _____ A ka në ese një paragraf që mbështet atë që kam thënë në fillim?
- _____ A kam qenë i kujdesshëm për të shmangur futjen e të dhënave të reja që nuk i kam raportuar?

Vlerësimi i nxënësve nga njëri – tjetri

Vlerësimi i shokut mund të shtojë edhe një dimension tjetër në zhvillimin e nxënësit nga pikëpamja e njohjes mbi veten. Gjatë konsultimeve me shokët e tyre për marrjen dhe dhënien e sugjerimeve për përmirësim, marrin më shumë përgjegjësi për atë që bëjnë dhe mënyrën si e realizojnë. Kështu, ata mendojnë në mënyrë analitike mbi natyrën e performancës së shokut të tyre. Projektet, si detyra që përfshijnë një kombinim të aftësive të nxënies, si: kërkimi, planifikimi, projektimi dhe përfundimi, janë shembuj të mirë. Kjo praktikohet në ato situata ku nxitet një shkallë e lartë e ndërveprimit të nxënësit.

Praktika ka treguar se *vlerësimi i ndërsjellë* është mjaft i efektshëm. Metoda e vlerësimit të nxënësve për njëri – tjetrin siguron një të kuptuar më të plotë mbi nevojat, problemet, interesat, qëndrimet e nxënësve ndaj çështjeve të veçanta dhe ndihmon në vlerësimin e gatishmërisë për të nxënë. Teksa nxënësit vlerësojnë punën e bashkëmoshatarëve, ata mund të qartësojnë idetë e tyre për rezultatet e të nxënës dhe kriteret e vlerësimit të detyrave. Ky vlerësim duhet të zbatohet me kujdes dhe arritjet e nxënësve duhet të krahasohen me arritjet e tyre të mëparshme e jo me të tjerët.

Rregullat që duhen ndjekur gjatë vlerësimit të ndërsjellë duhet t'u tregohen dhe t'u shpjegohen nxënësve para çdo vlerësimi të ndërsjellë. Ato janë:

- *Dëgjoni me vëmendje shoku – shokun.*
- *Mos i ndërprisni të tjerët kur flasin.*
- *Kërkoni sqarime, mos u nxitoni.*
- *Respektoni punën e partnerit.*
- *Filloni me pozitivizëm dhe inkurajim.*
- *Jini të qartë si mund të përmirësohet partneri juaj.*
- *Jini i ndershëm dhe shmangni kritikën e tepërt.*
- *Respektoni besueshmërinë.*

Teknika për vlerësimin e ndërsjellë

1. Takime të shkurtra për të përmirësuar të shkruarit

Kjo teknikë është e përshtatshme për punët me shkrim. Në takimet e shkurtra gjysma e klasës qëndron e ulur në bankë (p.sh., në punimin e një eseje), gjysma tjetër lëviz prej bankave çdo 5 minuta. Kështu, çdo nxënës takohet me një partner tjetër çdo 5 minuta. Gjatë këtyre 5 minutave (kohës për takimet e shkurtra/e shpejta), çdo partner lëvizës zë vend pranë partnerit të ulur. Partnerët japin komente dhe sugjerime rreth asaj që kanë dëgjuar apo parë. Deri në fund të orës mësimore, çdo nxënës do të ketë disa këndvështrime të ndryshme rreth të gjitha pjesëve të punimit të tij.

2. Dy yje dhe një dëshirë

Kjo teknikë siguron një strukturë zhvillimore pozitive, që i ndihmon nxënësit të vlerësojnë dhe të raportojnë për punën e njëri – tjetrit.

- *Nxënësit shkëmbejnë detyrat e tyre dhe reflektojnë për punën e tjetrit.*
- *Nxënësi kontrollues (kontrolluesi) identifikon dy elemente/ide pozitive (yje) në detyrën e shokut/shoqes dhe një aspekt tjetër të punës/detyrës ku ka nevojë për përmirësim apo zhvillim të mëtejshëm (dëshirë).*
- *Mund të ketë një yll (ose më shumë se dy yje), apo nxënësi mund të jetë i kënaqur me detyrën dhe nuk ka vend për asnjë dëshirë.*
- *Komunikimi i yjeve dhe i dëshirave mund të jetë në formë të shkruar, me gojë apo në forma tjera (vizatime, imazhe etj.).*

Kjo teknikë mund të përdoret nga vetë mësuesi, kur u jep nxënësve të dhëna për punën e bërë, apo edhe kur nxënësi e vlerëson punën e tij (vetëvlerësimi).

3. Kontrolli para fluturimit

Kjo teknikë na siguron se detyra që dorëzohet në portofol i përmbush të paktën kërkesat minimale të lidhura me kriteret e arritjeve.

- *Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri – tjetrin, duke e krahasuar detyrën e shokut/shoqes me listën e kriterëve të paraqitura për të gjithë nxënësit.*
- *Nxënësi (kontrolluesi) duhet të sigurohet se në punën e shokut/shoqes janë përfshirë elementet themelore.*
- *Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet.*
- *Nxënësi (autori) i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij.*



MODELE/SHEMBUJ TË PORTOFOLAVE TË TË NXËNIT SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT

FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Model portofoli për periudhën e parë

Lënda: Letërsi

Klasa X

Përgatiti: Enkelejda Dano, mësuese në gjimnazin “Mustafa Qemal Atatürk”, Vlorë

Nr.	Përmbajtja e portofolit	Pikë	Kriteret	Afati
1	Ese dhe krijimtari e lirë “Prometeu në sytë e mi.” (video, fotografi, vizatime, piktura etj.)	15	Respektimi i strukturës së esesë 2 pikë Reflektimi i njohurive të marra për temën që trajtohet 3 pikë Niveli i argumentimit dhe reflektimit mbi temën që trajtohet 3 pikë Qartësia e mendimit 2 pikë Respektimi i rregullave të drejtshkrimit dhe paraqitja estetike 5 pikë	Java e fundit e tetorit
2	Projekt Analiza e krijimtarisë së Shekspirit e konkretizuar në tragjedinë “Mbreti Lir”.	15	Organizimi i punës së grupit: 1 pikë Cilësia e informacionit dhe e materialeve 4 pikë Mënyra e të shprehurit dhe e ndërtimit të artikujve 3 pikë Paraqitja grafike 2 pikë Estetika dhe individualiteti i punimeve 3 pikë Respektimi i afateve kohore 2 pikë	Java e parë e dhjetorit

Kriteret e vlerësimit të portofolit sipas shumës së pikëve

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16 - 19	20-23	24-27	28-30

Model projekti

Lënda: Letërsi

Klasa XI

Përgatiti: Entela Kazazi, mësuese në gjimnazin “Kostandin Kristoforidhi”, Elbasan

Tema: “Një ditë në teatrin e shkollës”

Rezultatet e të nxënës:

Nxënësi:

- interpreton vepra e fragmente nga gjini të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe nga letërsia botërore;
- analizon veçoritë e romantizmit në një vepër dramatike;
- analizon veçoritë e realizmit në një roman;
- kthen një fragment proze në një tekst dramatik, duke respektuar veçoritë e tij;
- analizon tiparet e simbolizmit;
- lidh tekstin që lexon me jetën e përvojat e tij, si dhe me botën që e rrethon;
- interpreton me ndjenjë role të ndryshme personazhesh të një teksti dramatik;
- përzgjedh elementet e dekorit dhe të skenës, në funksion të përmbajtjes së një teksti dramatik ose të një teksti poetik;

Lidhja me fushat e tjera: Artet, shoqëria dhe mjedisi, TIK-u.

Numri i orëve që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit: 5 orë

Numri i nxënësve në projekt: Të gjithë nxënësit e klasave XI

Njohuritë kryesore që rimerren në projekt:

- Shkrimi i një plani veprimtarish.
- Tiparet e romantizmit, përfaqësuesit kryesorë dhe gjinitë letrare që u lëvruan.
- Tiparet e komedisë në veprën e Çajupit.
- Tiparet e realizmit, përfaqësuesit kryesorë dhe gjinitë letrare që u lëvruan.
- Analizë e romanit “Xha Gorio” të Balzakut.
- Tiparet e simbolizmit, përfaqësuesit kryesorë dhe gjinitë letrare që u lëvruan.
- Veçoritë e krijimtarisë poetike të simbolistëve.
- Kushtet historiko - shoqërore në periudhat e romantizmit, realizmit dhe simbolizmit. Artet që u zhvilluan gjatë këtyre periudhave.
- Shkrimi i teksteve dramatike duke u mbështetur në disa tekste në prozë.
- Përgatitja dhe prezantimi i një detyre.

Partnerët:

- Mësues të gjuhës, letërsisë, historisë dhe arteve;
- Aktorë të teatrit, gazetarë, regjisorë etj.

Burimet:

- Veprat e plota të autorëve.
- Kritikë letrare për veprat dhe autorët.

Produkti final:

Vënie në skenë e fragmenteve nga drejtime të ndryshme letrare (romantizmi, realizmi, simbolizmi).

- **Grupi 1:** Grupi i romantizmit (A. Z. Çajupi “14 vjeç dhëndër”)
- **Grupi 2:** Grupi i realizmit (Balzak “Xha Gorio”)
- **Grupi 3:** Grupi i simbolizmit [poezi të shkëputura nga Sh. Bodler (*Ch. Baudelaire*), E. A. Poe (*Edgar Allan Poe*), P. Verlen (*Paul Verlaine*), A. Rembo (*Artur Rembo*), S. Mallarmé (*Stéphane Mallarmé*) etj.]

Përshkrimi i veprimtarive që do të zhvillohen në projekt:

Fazat	Përshkrimi i veprimtarive
FAZA I	Diskutime rreth temës së projektit.
Periudha	Ndarja e grupeve të punës sipas tematikave (3 grupe pune). Zgjedhja e kryetarëve brenda grupeve. Udhëzime për planet e grupit dhe planet individuale të nxënësve.
Shtator-Dhjetor	Hulumtimi në bibliotekë apo internet për drejtimet letrare dhe autorët përfaqësues.
15 pikë	Përgatitja e një relacioni ku të tregohen cilat janë detyrat që nxënësi ka brenda grupit, si dhe hapat e punës që ka realizuar deri tani apo që do të realizojë në vazhdimësi.
FAZA II	Leximi i veprës së autorëve përfaqësues të secilit drejtim letrar.
Periudha	Diskutime me grupet e punës mbi kërkimet e kryera në bibliotekë për leximin e veprave të plota, përzgjedhjen e informacionit, nxjerrjen e shënimeve, klasifikimin e materialeve etj.
Janar-Mars	Prezantimi i punimeve të deritanishme të nxënësve mbi secilin drejtim letrar si dhe autorët përfaqësues. Punohet veçanërisht me nxënësit të cilët kanë detyrë brenda grupit që të shkruajnë skenarin e veprave në prozë, për ta përshtatur atë për realizimin skenik. Diskutimi mësues - nxënës dhe nxënës - nxënës i ndihmon ata të përfitojnë ide nga sugjerimet e njëri - tjetrit.
15 pikë	Çdo nxënës dorëzon produktin e vet të punës: skenarin; përshtatjen e teksteve; propozimet për regjinë, skenën dhe veshjet etj.
FAZA III	
Periudha	Vënie në skenë e tre fragmenteve nga tre grupet e punës.
Prill -Qershor	Diskutime rreth interpretimeve, skenës, kostumeve etj.
20 pikë	

Kriteret e vlerësimit të nxënësve janë:

- Respektimi i tematikës;
- Realizimi i planit të projektit për çdo grup;
- Hulumtimi dhe menaxhimi i informacionit;
- Etika e punës në grup;
- Përfundimet e nxjerra nga secili grup pune;
- Interpretimi i rolit, realizimi i skenografisë, i grimit, i efekteve të zërit etj;
- Realizimi i dokumentarit përmes programeve kompjuterike;
- Realizimi i dekorit, i kostumeve, i grimit, i skenografisë, i efekteve të zërit etj.;
- Përvetësimi i kompetencave kyçe dhe lëndore nga nxënësit;
- Respektimi i afatit të dorëzimit të projektit.

Niveli I: nota 4

Nuk merr pjesë në punën e grupit, nuk përfshihet në punën e tij dhe nuk dorëzon produktin përfundimtar.

Niveli II: nota 5 – 6

Përgatit dhe realizon një plan sipërfaqësor të punës së vet; përgatit një material të pjesshëm me shkrim dhe e dorëzon brenda afatit; përfshihet dhe jep një kontribut sipërfaqësor në realizimin e planit të grupit.

Niveli III: nota 7 – 8

Përgatit dhe realizon një plan të punës së vet brenda grupit; përgatit një material të mjaftueshëm me shkrim dhe e dorëzon brenda afatit; trajton temën e kërkuar duke përdorur informacionin e dhënë dhe respekton kriteret e kërkuara (jo më pak se 2 faqe); shtjellon argumentin e temës dhe respekton afatet kohore; interpreton në mënyrë shprehëse rolin e vet brenda grupit ose realizon me sukses punën si regjisor, grimier, kostumograf, fotograf etj.

Niveli IV: nota 9 – 10

Rendit qartë dhe në mënyrë logjike materialin e marrë në shqyrtim; shkruan një tekst të qartë dhe koherent, ku përshkruan vlerat e drejtimit letrar që përfaqëson dhe autorët përkatës; është origjinal në trajtimin e temës; përdor saktë dhe me korrektësi literaturën; përdor një gjuhë të saktë, të qartë dhe pa gabime; interpreton në mënyrë shprehëse rolin e vet dhe ndihmon në realizimin e punës të pjesëtarëve të tjerë të grupit.

Vlerësimi i nxënësve për projektin

Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 0 – 10 pikë	Niveli 2 11 – 21 pikë	Niveli 3 22 – 32 pikë	Niveli 4 33 – 40 pikë
15 pikë (Faza e parë)	0 – 4 pikë	5 – 8 pikë	9 – 12 pikë	13 – 15 pikë
15 pikë (Faza e dytë)	0 – 4 pikë	5 – 8 pikë	9 – 12 pikë	13 – 15 pikë
20 pikë (Faza e tretë)	0 – 6 pikë	7 – 11 pikë	12 – 16 pikë	17 – 20 pikë

Shembull portofoli

Portofoli i të nxënit

Lënda: Matematikë

Fusha: MATEMATIKË

Klasa XI

Punoi: Lumturi Allkushi, mësuese në gjimnazin “Hasan Tahsin”, Sarandë

Rubrikat e portofolit

1. Projekte kurrikulare të punuara në grup (15 pikë)
2. Detyra 1 zbatim/punim (10 pikë)
3. Detyra 2 hulumtim (10 pikë)

Kompetencat kyçe

1. Komunikimi dhe të shprehurit
2. Të menduarit
3. Të nxënit
4. Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
5. Personale
6. Qytetare
7. Digjitale

Kompetencat e lëndës

1. Zgjidhja problemore
2. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik
3. Lidhja konceptuale
4. Të menduarit dhe komunikimi matematik
5. Modelimi matematik

Projekt kurrikular (periudha e parë)

Tema: Hapja e biznesit (përgatitjet e fundit)

Afati: Java e parë e dhjetorit

Mënyra e realizimit

1. Përbërësit (lista e artikujve)
2. Lista e çmimeve
3. Takim me furnitorin.

Mënyra e organizimit: Punë me grupe

Kompetencat e lëndës

1. Zgjidhja problemore
2. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik
3. Lidhja konceptuale
4. Të menduarit dhe komunikimi matematik
5. Modelimi matematik

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- integron njohuritë dhe shprehjet matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme);
- krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore, si: klasifikimi dhe pasqyrimi i të dhënave të një ndërmarrjeje, një biznesi etj. në tabela, për një studim statistikor.

Lidhja me lëndë të tjera: *Ekonomi, Biznes, TIK.*

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët
1	Burimet e informacionit dhe përpunimi i mirë	3 pikë
2	Saktësia e klasifikimi të të dhënave në tabela	3 pikë
3	Estetika e paraqitjes dhe saktësia drejtshkimore	3 pikë
4	Prezantimi i punës dhe aftësia krijuese	3 pikë
5	Respektimi i afatit kohor	3 pikë

Detyra 1 (Individuale)

Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- zbaton konceptet bazë të trupave gjeometrikë,
- modelon trupat gjeometrikë dhe krijon një trup me kombinimin e vet.

Afati: Java e tretë e tetorit

Nr.	Kriteret e vlerësimit D1	Pikët
1	Ndërtimi i trupave gjeometrikë dhe mënyra e hapjes së tyre	3 pikë
2	Zbatimi i koncepteve bazë matematikore për trupat gjeometrikë	2 pikë
3	Modelimi i një objekti me trupa të kombinuar	3 pikë
4	Llogaritja e vëllimit dhe e sipërfaqes së objektit të ndërtuar (me kompjuter ose punim me dorë)	2 pikë

Detyra 2 (Punë në çift)

Faturat e energjisë dhe të ujit (seritë kohore)

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- zbaton konceptet bazë për ndërtimin e grafikut,
- hulumton duke përdorur metoda statistikore për mbledhjen e të dhënave.

Afati: Java e tretë e nëntorit.

Nr.	Kriteret e vlerësimit D2	Pikët
1	Sistemimi i të dhënave në tabela	2 pikë
2	Paraqitja e të dhënave në rrjetin koordinativ dhe ndërtimi i grafikut	5 pikë
3	Llogaritja e përqindjes së shpenzimeve për energji dhe ujë në varësi të të ardhurave mujore të familjes	3 pikë

Shembull evidence për mbajtjen e rezultateve të portofolit.

Nr.	Emër	Mbiemër	Pikët D 1	Pikët D 2	Pikët Projekti	Pikët totale	Nota
1	Bleart		8 pikë	9 pikë	12 pikë	29 pikë	9
2	Eliona						
.....							
.....							
.....							

Kriteret e vlerësimit të portofolit sipas shumës së pikëve

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0 - 8	9 - 12	13 - 16	17 - 20	21 - 25	26 - 30	31 - 35

Shembull

Projekt kurrikular me shtrirje gjithëvjete për lëndën e matematikës

Klasa X

Punoi: Mirjana Canellari, mësuese, Tiranë

1. **Tema e projektit:** “Plani i një biznesi dhe fillimi i tij”
2. **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:** Projekti do të zgjasë përgjatë tri periudhave të realizuara në 9 orë mësimore në lëndën e matematikës, të planifikuara 3 orë për çdo periudhë.
3. **Klasa/t pjesëmarrëse:** Klasat X a, b, c, d, e
4. **Rezultatet e të nxënës.** Në përfundim të projektit nxënësi:
 - demonstroi njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave;
 - përgatiti pyetësorë dhe intervista;
 - lexoi dhe kuptoi të dhënat statistikore për të marrë vendime në jetën e përditshme;
 - interpretoi të dhënat dhe konsolidoi konceptin e modës, mesatares aritmetike, mesores, korrelacionit, treguesit e shpërndarjes;
 - kryen veprime me numra për të parashikuar të ardhurat, shpenzimet dhe fitimet e tij;
 - kryen vërtetime, ndërton dhe interpreton tabelave dhe diagrame të të dhënave të grumbulluara;
 - përdor terminologjinë matematikore për të analizuar, për të komunikuar dhe për të zbuluar informacion matematikor në situata të ndryshme nga jeta e përditshme;
 - bën lidhje ndërmjet koncepteve dhe procedurave matematikore;
 - prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërrshetur format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
 - bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht në progresin e grupit.
5. **Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:**
 - pyetja kërkimore, qëllimi i studimit;
 - pyetësori, intervista, popullata, kampionimi;
 - grumbullimi i të dhënave;
 - përpunimi i të dhënave;

- tabelat, diagramet;
 - moda, mesorja, mesatarja aritmetike, korrelacioni, shpërndarja;
 - interesi financiar, llogaritja e kostos, vetitë e fuqive, vlerësimi i zgjidhjeve;
 - shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave dhjetorë me fuqi të dhjetës;
 - rrumbullakimi i numrave natyrorë dhe dhjetorë;
 - paraqitja grafike e të dhënave;
 - interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.
6. **Partnerët që do marrin pjesë në projekt:** prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.
7. **Veprimtaritë kryesore:**
- Diskutim me nxënësit për përzgjedhjen e temës së projektit.
 - Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
 - Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup.
 - Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
 - Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
 - Kërkime të ndryshme në literaturën e rekomanduar apo në internet, në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre hulumtuese dhe studimore.
 - Hartimi i pyetësorit (i intervistave), përcaktimi i popullatës dhe përzgjedhja e kampionit me të cilin do të kryhet pyetësori (intervistat).
 - Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët (intervistat), komunikimi me mësuesit, prindërit, anëtarët e komunitetit, nxënësit sipas popullatës së përzgjedhur.
 - Përpunimi i të dhënave.
 - Ndërtimi i tabelave, diagrameve etj.
 - Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
 - Hartimi i draftit përfundimtar të projektit falë punës në grup dhe punës individuale.
 - Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit.
8. **Burimet kryesore të informacionit:**
- Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve (intervistave).
 - Bisedat me prindër dhe mësues.
 - Materiale nga interneti (nëse është e mundur).
 - Teksti mësimor i matematikës për klasën X.
 - Tekste të tjera lëndore që lidhen me situatën konkrete.

- Konsulta me specialistë të biznesit që lidhen me situatën konkrete.
- Revista, buletine të ndryshme.

Baza materiale:

- letra të bardha,
- kartonë,
- lapustila,
- fletë punëdore,
- foto,
- ngjites etj.

9. Tematika e orëve të planifikuara:

- *Ora e 1-rë.* Përzgjedhja e temës së projektit, ndarja e grupeve, përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup, ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit, hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- *Ora e 2-të.* Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i pyetësorëve (intervistave), përcaktimi i popullatës dhe përzgjedhja e kampionit me të cilin do të kryhet pyetësori (intervistat), konsulentët që mund të anketohen.
- *Ora e 3-të.* Shpërndarja e pyetësorëve në atë kampion ku është planifikuar të bëhet, grumbullimi i informacionit nga pyetësorët (intervistat), grumbullimi i materialit nga burime të tjera.
- *Ora e 4-të.* Përpunimi i materialit të grumbulluar, përpunimi i të dhënave të marra nga pyetësorët etj.
- *Ora e 5-të.* Ndërtimi i tabelave, diagrameve dhe diskutimi i tyre; diskutimi i intervistave.
- *Ora e 6-të.* Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
- *Ora e 7-të.* Hartimi i draftit përfundimtar të projektit dhe diskutimi i tij.
- *Ora e 8-të.* Prezantimi i materialit të përgatitur, vlerësimi i punës në grup dhe vlerësimi individual i nxënësve.
- *Ora e 9-të.* Prezantimi i materialit të përgatitur, vlerësimi i punës në grup dhe vlerësimi individual i nxënësve.

10. Përshkrimi i produktit të projektit

- Projekti do të përmbajë krijimin e planit të një biznesi dhe fillimin e tij. Për të realizuar këtë projekt nxënësit do të mbledhin informacione që lidhen me detyrën hulumtuese të secilit grup. Detyra hulumtuese ka të bëjë me studimin e tregut që lidhet me biznesin përkatës, të ardhurat që mund të mbledhin nga ky biznes gjatë vitit të parë, të gjykojnë rreth aksioneve që do të ketë secili në këtë biznes, të gjykojnë nëse do t'u duhet të marrin kredi, të gjejnë

vendndodhjen e këtij biznesi, çfarë logoje mund të përdorin, mobilimin për të pasur sa më shumë komoditet etj.

- Projekti do të shkruhet dhe do të prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:
- Tema e projektit.
- Rezultatet e të nxënit.
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Tabela lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili prej anëtarëve të grupit. Një shembull tabele i planit të veprimtarive paraqitet më poshtë.

Faza e parë

Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtari i grupit
P.sh., hartimi i pyetësorit	15 tetor 201...	Anëtari
P.sh., përcaktimi i kampionit; gjetja e konsulentëve	20 tetor 201...	Anëtari

Faza e dytë

P.sh., grumbullimi i materialit nga burime të tjera	10 janar 201...	Anëtari
P.sh., ndërtimi i tabelave, diagrameve	2 shkurt 201...	Anëtari

Faza e tretë

P.sh., shkrimi i materialit	9 mars 201...	Anëtari
P.sh., punimi i materialit në kompjuter	3 prill 201...	Anëtari
P.sh., përgatitja e projektit për prezantim	15 prill 201...	Anëtari

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. (Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme, si: të shkruhen në një poster; të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë; të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik *Power point*, nëse është produkt prezantohet produkti etj.)
- Konkluzione të projektit.

Detyra hulumtuese që rekomandohen për shtjellimin e temës së projektit:

- Plani i hapjes së një restoranti dhe fillimi i tij.
- Plani i hapjes së një supermarketi dhe fillimi i tij.
- Plani i hapjes së një restoranti me ushqim të shpejtë dhe fillimi i tij.
- Plani i hapjes së një dyqani celularësh dhe fillimi i tij.
- Tema të tjera të sugjeruara nga nxënësit.

11. Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet për vlerësimin e projekteve kurrikulare të përcaktuara sipas niveleve

Tabela 1. Instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit nga mësuesi		
Projekt kurrikular hulumtues		
Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjatë gjithë vitit)		
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët 0 – 10 pikë	Niveli 2 – Mjaftueshëm 11 – 21 pikë
15 pikë - (Faza e parë)	0 – 4 pikë	5 – 8 pikë
Demonstrimi i aftësive hulumtuese	Nxënësit rrallëherë fokusohen te detyra e tyre. Mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. Përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre. Mbledhin informacione dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.
15 pikë - (Faza e dytë)	0 – 4 pikë	5 – 8 pikë
Zgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme matematikore	Nxënësit rrallëherë përdorin teknika matematikore të përshtatshme. Zgjidhja përmban shumë gabime matematikore.	Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika matematikore të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme matematikore.
10 pikë - (Faza e tretë)	0 – 2 pikë	3 – 5 pikë
Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit	Në prezantimin e tyre materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri – tjetrin. Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.	Në prezantimin që bëjnë, nxënësit e organizojnë mirë punën e tyre, e cila jo gjithmonë të krijon lehtësi në të dëgjuar dhe në të kuptuar. Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.

të mësipërme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situata të ndryshme dhe arsyetimet intuitive.
- Përdorimi i saktë i koncepteve matematikore.
- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme matematikore.
- Angazhimi i çdo nxënësi në realizimin e projektit individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, në mënyrë që të lexohet, të dëgjohet dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
22 – 32 pikë	33 – 40 pikë
9 – 12 pikë	13 – 15 pikë
Nxënësit, shumicën e kohës, janë të fokusuar te detyra e tyre. Mbledhin informacione dhe gjejnë zgjidhje standarde. Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit janë të fokusuar te detyra e tyre. Vetorientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Mbledhin informacione në mënyrë aktive dhe krijojnë komente intuitive për të zgjidhur probleme. Përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
9 – 12 pikë	13 – 15 pikë
Nxënësit zakonisht përdorin teknika matematikore të përshtatshme dhe efektive. Zgjidhja përmban pak gabime matematikore.	Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika matematikore të përshtatshme dhe efektive. Zgjidhja nuk përmban gabime matematikore.
6 – 8 pikë	9 – 10 pikë
Në prezantimin që bëjnë, nxënësit e organizojnë mirë punën e tyre, e cila në shumicën e kohës të krijojnë lehtësi në të lexuar, në të dëgjuar dhe në të kuptuar.	Në prezantimin e tyre nxënësit e organizojnë shumë mirë punën, e cila të krijojnë lehtësi në të lexuar, në të dëgjuar dhe në të kuptuar.
Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.	Rezultatet e projektit prezantohen qartë.

Tabela 2. Instrument i vetëvlerësimit ose i vlerësimit të nxënësit nga nxënësi

Kriteret për vlerësimin e projektit					
Projekt kurrikular hulumtues					
<i>Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjatë gjithë vitit)</i>					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	Sh.m.	M.	Mj.	D.
15 pikë (Faza e parë)	Demonstrim i aftësive hulumtuese				
	Bashkëpunimi në grup. Grupi orientohet dhe drejtohet vetë				
	Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve				
	Demonstrimi i aftësive hulumtuese				
15 pikë (Faza e dytë)	Fokusimi te detyra e dhënë				
	Mbledhja e informacioneve të përshtatshme për detyrën				
	Përdorimi gjatë gjithë projektit i teknikave matematikore të përshtatshme dhe efektive				
	Zgjidhja nuk përmban gabime matematikore				
10 pikë (Faza e tretë)	Përdorimi i skemave ose diagrameve të ndryshme				
	Organizimi i materialit që të krijon lehtësi në të lexuar, në të dëgjuar dhe në të kuptuar				
	Rezultatet e projektit prezantohen qartë				
	Kontribuon pozitivisht në progresin e grupit				
Prezantimi dhe komunikimi në mënyrë efektive i rezultateve të projektit					

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Model portofoli – Periudha e tretë

Lënda: Gjeografi

Klasa 11

Punoi: Blendi Bakalli, mësues

Përmbajtja e portofolit

1. Detyrë tematike: Zhvillimet demografike dhe ekonomike të Rajonit Verior - Verilindor, Rajonit Jugor-Juglindor të Republikës së Shqipërisë.

Rezultatet e të nxënit.

Nxënësi/Nxënësja:

- hulumton në mënyrë të pavarur për të gjetur informacion të saktë në burime shkencore në përputhje me çështjet e kërkuara;
- përzgjedh nga informacioni i grumbulluar çështjet më kryesore që pasqyrojnë zhvillimin e procesit;
- argumenton informacionin për çështje që tregojnë mënyrën se si ndodhin zhvillimet natyrore e hapësinore të popullsisë shqiptare dhe perspektivat për të ardhmen;
- përdor TIK-un në mënyrë të efektshme për të pasqyruar rezultatet e punës së vet përmes paraqitjes estetike.

Detyrat sipas grupeve në funksion të temës kryesore:

- *Braktisja masive në rajonin Verior – Verilindor pas vitit 1990, faktorët migrues dhe pasojat përmes fakteve dhe shembujve.*
- *Rajoni Juglindor dhe Jugor ofron një trashëgimi të pasur dhe të larmishme kulturore kombëtare. Guidë udhërrëfyese për t'i vizituar ato.*

2. Projekt: Perspektiva e zhvillimit të turizmit në trevat shqiptare. (Faza III) Finalizimi i projektit, prezantimi dhe mbrojtja e përfundimeve dhe gjetjeve.

Rezultatet e të nxënit.

Nxënësi/Nxënësja:

- përzgjedh përfundimisht burimet e informacionit që mundësojnë informacionin shkencor;
- përpunon informacionin personal (individual) në funksion të punës përfundimtare në grup;
- bashkëpunon në grup për seleksionimin e bazës shkencore, përpunimin e fotove, grafikëve në bazë të draftit;
- përdor TIK-un në mënyrë efektive për të pasqyruar rezultatet e punës së vet dhe në grup, të shprehur në origjinalitetin e prezantimit;
- argumenton qëndrimet në mënyrë logjike dhe me saktësi shkencore;
- harton raportin përmbledhës duke nxjerrë në pah përfundimet dhe sugjerimet.

3. Ndërtimi, interpretimi dhe analiza e hartave që pasqyrojnë tiparet fiziko – gjeografike dhe humane të rajonit Veri – Verilindor, Jugor dhe Juglindor të Republikës së Shqipërisë

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/Nxënësja:

- ndërton hartat sipas metodave të përcaktuara,
- përdor saktë teknikat e ndërtimit dhe ngjyrosjes së hartave,
- prezanton qartë dhe saktë hartat e ndërtuara përmes interpretimit shkencor.

Kriteret e vlerësimit për çdo detyrë:

Detyrë tematike: Zhvillimet demografike dhe ekonomike të Rajoneve Verilindor, Jugor dhe Juglindor të Republikës së Shqipërisë.

Saktësia e burimeve të informacionit	1
Estetika e prezantimit dhe e punimit	2
Origjinaliteti i punimit	2
Saktësia shkencore në analizën e dukurisë gjeografike	2
Totali	7

Projekt: Perspektiva e zhvillimit të turizmit në trevat shqiptare

Saktësia e burimeve të informacionit	1
Veçantia (risia) e prezantimit të gjetjeve të projektit	2
Saktësia shkencore e informacionit të prezantuar	2
Përcaktimi i qartë i përfundimeve dhe i sugjerimeve; raporti përfundimtar	2
Totali	7

Ndërtimi, interpretimi dhe analiza e hartave që pasqyrojnë tiparet fiziko – gjeografike dhe humane të rajonit Veri – Verilindor, Jugor dhe Juglindor të Republikës së Shqipërisë.

Estetika e prezantimit dhe e punimit të hartave	2
Interpretimi shkencor i dukurisë gjeografike që pasqyrohet në hartë	2
Total	4

Dorëzimi në kohë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Koha	Portofoli
Pikët	6	6	6	2	20
Pikët e fituara					

Vlerësimi me pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10	Niveli i arritjes
Pikët	5	6 - 7	8 - 10	11 - 13	14 - 15	16 - 17	18 - 20	

Model – Projekt kurrikular

Lënda: Gjeografi

KLASA 11

Tema: Zhvillimet e sotme turistike në Shqipëri, perspektiva për të ardhmen

Numri i orëve të planifikuara: 6 orë mësimore

Rezultatet e të nxënit:

- Nxjerr në pah veçoritë e pozicionit gjeografik të Shqipërisë dhe të trevave shqiptare si dhe veçoritë e zhvillimit të turizmit.
- Analizon faktorët natyrorë që mundësojnë zhvillimin e turizmit në Shqipëri.
- Analizon faktorët humanë që mundësojnë zhvillimin e turizmit në Shqipëri.
- Tregon qartë, përmes mjeteve të ndryshme të informimit, pikat më të rëndësishme turistike në Shqipëri.
- Mban qëndrime për problematikat mjedisore dhe shoqërore që pengojnë zhvillimin e turizmit.
- Demonstron aftësi në përzgjedhjen e temës si dhe në grumbullimin dhe përpunimin e materialeve.
- Demonstron aftësi për të prezantuar, duke përdorur drejt gjuhën e shprehur, të shkruar dhe TIK-un.
- Mban qëndrim kritik ndaj punëve të propozuara.
- Demonstron etikë ndaj qëndrimeve, mendimeve të të tjerëve, punës në grup dhe ndaj punës së tij.

Njohuritë kryesore që do të përdoren

- Të dhënat nga teksti mësimor dhe studime të ndryshme gjeografike;
- Njohuritë e marra në klasën e nëntë dhe të dhjetë për proceset natyrore dhe humane të rajoneve në Shqipëri dhe në trevat shqiptare;
- Analiza e të dhënave statistikore, ndërtimi i grafikëve dhe i hartave përkatëse;
- Njohuritë e marra në Programet *Word*, *Excel* dhe *PowerPoint* në përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen grafike të informacionit si dhe GIS (është shkurtesë për *Geographic Information System*).

Partnerë në projekt: Nxënësit, prindërit, mësuesit e lëndëve *Informatikë*, *Matematikë*, *Gjuhë shqipe*, *Letërsi* etj.

Numri i nxënësve të përfshirë në projekt: Nxënësit e klasave 11C, 11D

Veprimtaritë kryesore

Nr.	Veprimtaria	Afati	Përgjegjësi
1	Përcaktimi i temës së projektit në bashkëpunim me nxënësit pas propozimit të disa temave. Hartimi i një liste paraprake të burimeve të informacionit, që do të mbështesë studimin. Përcaktimi i detyrave për secilin grup dhe nxënës.	Periudha e parë	Mësuesi dhe nxënësit Produkti: Hartimi dhe dorëzimi i dokumentit që pasqyron: temën e grupit, nënçështjen individuale, burimet e informacionit ku do mbështetet dhe hapat për fazat pasardhëse
2	Përdorimi nga nxënësit i literaturës mësimore të rekomanduar. Takime të vazhdueshme me mësuesin dhe specialistë të fushës, për grumbullimin e informacionit të nevojshëm. Grumbullimi përfundimtar i të dhënave dhe menaxhimi i informacionit. Fillimi i plotësimit të portofolit të nxënësit me gjetjet kryesore.	Periudha e dytë	Grupet e punës, nxënësit Mësuesit, prindërit Produkti: Mbrojtja paraprake e draft prezantimit të projektit: materialet e mbledhura, foto, video, gjetjet fillestare etj.
3	Diskutimi në klasë i gjetjeve kryesore, prezantimi. Vetëvlerësimi i punës në grup dhe i punës individuale	Periudha e tretë	Grupet e punës dhe nxënësit Mësuesit dhe nxënësit Produkti: Prezantimi final (fletëpalosje, PowerPoint, maket etj.) Raporti përfundimtar dhe vetëvlerësimi.

Burimet kryesore të informacionit

- Tekstet mësimore: *Gjeografia 10*, *Gjeografia e trevave shqiptare* për klasat 9 dhe 12.
- Burime të tjera informacioni, si: enciklopedi të ndryshme, faqe në web, adresa të ndryshme interneti me fokus gjeografinë dhe zhvillimin e hapësirës etj.
- Biseda me specialistë të fushave të ndryshme nga të cilët mund të grumbullohen të dhëna etj.
- Vëzhgime në terren (foto) etj.

Produkti i pritshëm i projektit

Raporti përfundimtar ku pasqyrohen etapat e zhvillimit të studimit, gjetjet kryesore, masat e propozuara për të minimizuar problematikat mjedisore, sociale, ekonomike etj. Gjetja e rrugëve më të mira për të paraqitur arritjet/ zbulimet e studimit për zhvillimin e turizmit në Shqipëri dhe në trevat shqiptare. Mbrojtja e gjetjeve të punimit përmes maketeve, fletëpalosjeve, albumeve fotografike, video - montazheve etj.

Tematika e orëve të planifikuara

- Ndarja e detyrave për secilin nxënës dhe literatura e rekomanduar.
- Realizimi i bisedave me specialistë të fushës, prindër dhe mësues.
- Grumbullimi i të dhënave sipas detyrave të përcaktuara.
- Diskutimi në klasë i rezultateve kryesore paraprahe të nxënësve.
- Përzgjedhja e rezultateve për raportin përfundimtar.
- Prezantimi i raportit përfundimtar.

Vlerësimi

Periudha e parë: Vlerësohet puna në grup, pjesëmarrja në diskutime, argumentet e dhëna për përzgjedhjen e temës, aftësia për t'u përfshirë në punën në grup, të shprehurit lirshëm dhe saktë etj.

Periudha e dytë: Vlerësohet saktësia e materialeve të përzgjedhura nga burime të ndryshme informacioni, saktësia shkencore e informacionit të grumbulluar, puna në grup me nxënësit e tjerë, përfshirja në sigurimin e materialeve në bashkëpunim me aktorë të tjerë, dorëzimi në kohë dhe hartimi i qartë i draft prezantimit të punimit.

Periudha e tretë: Vlerësohet origjinaliteti i prezantimit të gjetjeve të projektit, pastërtia e punimit, hartimi i raportit përfundimtar, argumentet e përdorura, analiza e përfundimeve dhe qëndrimet personale për çështjen që u trajtua.

Tema e grupit të 1-rë: Zhvillimet turistike në rajonin Verior – Verilindor të Shqipërisë

1. Pozicioni gjeografik dhe potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit
2. Potencialet humane për zhvillimin e turizmit
3. Llojet e turizmit që zhvillohen, tiparet dhe veçoritë
4. Turizmi dje dhe sot. Krahasime
5. Problematikat në zhvillimin e turizmit, masat për mënjanimin e tyre

Tema e grupit të 2-të: Zhvillimet turistike në rajonin Perëndimor të Shqipërisë

1. Pozicioni gjeografik dhe potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit
2. Potencialet humane për zhvillimin e turizmit
3. Llojet e turizmit që zhvillohen, tiparet dhe veçoritë
4. Turizmi dje dhe sot. Krahasime
5. Problematikat në zhvillimin e turizmit, masat për mënjanimin e tyre

Tema e grupit të 3-të: Zhvillimet turistike në rajonin Juglindor të Shqipërisë

1. Pozicioni gjeografik dhe potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit
2. Potencialet humane për zhvillimin e turizmit
3. Llojet e turizmit që zhvillohen, tiparet dhe veçoritë
4. Turizmi dje dhe sot, krahasime
5. Problematikat në zhvillimin e turizmit, masat për mënjanimin e tyre

Tema e grupit të 4-të: Zhvillimet turistike në rajonin Jugor të Shqipërisë

1. Pozicioni gjeografik dhe potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit
2. Potencialet humane për zhvillimin e turizmit
3. Llojet e turizmit që zhvillohen, tiparet dhe veçoritë
4. Turizmi dje dhe sot. Krahasime
5. Problematikat në zhvillimin e turizmit, masat për mënjanimin e tyre

Tema e grupit të 5-të: Zhvillimet turistike në Kosovë

1. Pozicioni gjeografik dhe potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit
2. Potencialet humane për zhvillimin e turizmit
3. Llojet e turizmit që zhvillohen, tiparet dhe veçoritë
4. Turizmi dje dhe sot. Krahasime
5. Problematikat në zhvillimin e turizmit, masat për mënjanimin e tyre

Tema e grupit të 6-të: Zhvillimet turistike në trevat shqiptare në Greqi, në Malin e Zi dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

1. Pozicioni gjeografik dhe potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit
2. Potencialet humane për zhvillimin e turizmit
3. Llojet e turizmit që zhvillohen, tiparet dhe veçoritë
4. Turizmi dje dhe sot. Krahasime
5. Problematikat në zhvillimin e turizmit, masat për mënjanimin e tyre

Model portofoli – Periudha e dytë

Lënda: Histori

Klasa XI

Komponentë	RN-të për kompetencat e lëndës	Kriteret e vlerësimit	Pikët	Gjithsej
Ese: <i>“Fan Noli dhe ndihmesa e tij në çështjen kombëtare shqiptare”</i>	Vlerëson rolin e Fan Nolit në procesin e parlamentarizmit të shtetit shqiptar në vitet 1921 – 1924.	Shtjellimi i idesë	6	15
		Struktura	4	
	Argumenton ndihmesën e tij në çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare.	Saktësia gjuhësore	3	
		Afati	2	
Veprimtare praktike: <i>Shqiptarët në Jugosllavi dhe në Greqi gjatë periudhës midis Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore</i>	Përshkruan gjendjen shoqërore, ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi.	Përmbushja e RN-së	4	10
	Përshkruan gjendjen shoqërore, ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Greqi.	Origjinaliteti	3	
		Pamje, ilustrime	2	
	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të tjerët për të realizuar veprimtarinë e përbashkët.	Afati	1	
Projekt kurrikular: <i>Figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes artit dhe letërsisë</i>	Identifikon dhe shqyrton të kaluarën historike të Gjergj Kastriot Skënderbeut.	Përpunimi i informacionit	8	25
		Bashkëpunimi në grup	5	
	Vlerëson rolin e folklorit si mjet për përcjelljen në kohë dhe hapësirë të epopesë së Skënderbeut.	Prezantimi	10	
	Tregon vendin që zë arti pamor në nxjerrjen në pah të figurës së Skënderbeut.			
	Merr përgjegjësi, punon në grup, përzgjedh materiale dhe diskuton për to.	Afati	2	
	Shqyrton burimet historike, për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet historike të epokës së Skënderbeut.			

Model portofoli – Periudha e dytë

Lënda: Filozofi

Klasa XI

Nr.	Përmbajtja e portofolit	Pikë	Kriteret	Afati
D 1	Projekt (faza II): Progresi i mendimit filozofik në rrjedhën e historisë	15	Respektimi i strukturës dhe i kërkesave të projektit 1 pikë (K 1) Cilësia e informacionit dhe materialeve 2 pikë (K 2) Pasurimi me materiale të reja dhe informacione shtesë 3 pikë (K 3) Origjinaliteti dhe individualiteti 2 pikë (K 4) Niveli i argumentimit dhe i qëndrimit kritik 2 pikë (K 5) Prezantimi 4 pikë (K 6) Respektimi i afateve kohore 1 pikë (K 7)	9 mars
D 2	Ese filozofike	10	Respektimi i strukturës 1 pikë (K 1) Reflektimi i njohurive të marra për temën që trajtohet 2 pikë (K 2) Niveli i argumentimit dhe i reflektimit mbi temën që trajtohet 4 pikë (K 3) Qartësia e mendimit 2 pikë (K 4) Respektimi i rregullave të drejtshkrimit dhe paraqitja estetike 1 pikë (K 5)	Do të caktohet në varësi të temave të zhvilluara
D 3	VEPRIMTARI PRAKTIKE Shteti, egoizmi i njerëzve dhe morali [mbështetur në filozofinë e T. Hobs (<i>Thomas Hobbes</i>) dhe N. Makiavelit (<i>Niccolò Machiavelli</i>)]	10	Shumëllojshmëria e burimeve të informacionit 2 pikë (K 1) Reflektimi i njohurive të marra për temën që trajtohet 3 pikë (K 2) Niveli i argumentimit dhe i reflektimit mbi temën që trajtohet 4 pikë (K 3) Respektimi i rregullave të drejtshkrimit dhe paraqitja estetike 1 pikë (K 4)	Java e tretë e shkurtit
	Vetëvlerësimi dhe reflektimi i nxënësit për përparimin e tij		Respektimi i afatit kohor	

Tabela e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 12	13 - 17	18 - 22	23 - 27	28 - 31	32 - 35

FUSHA: SHKENCAT E NATYRËS

Model Projekti

Lënda: Fizikë

Klasa 10

Punoi: N. Arapi, mësues

TEMA: Zbatime të ligjeve të mekanikës në praktikë dhe në jetën e përditshme

1. Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

- Kërkimi i përgjigjeve dhe i zgjidhjeve të problemeve shkencore
- Përdorimi i njohurive shkencore dhe teknologjike
- Komunikimi në gjuhën shkencore dhe teknologjike

2. Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi mëson për të nxënë: shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe të efektshme teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit, për të mbledhur materiale për detyrën e ngarkuar nga lideri i grupit.

Kompetenca e të menduarit dhe e të shprehurit

Nxënësi mendon në mënyrë krijuese: krahason të paktën tre burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë; argumenton saktësinë, rrethanat; gjen ngjashmëritë dhe dallimet,

Veprimtaritë e organizuara:

Nr.	Veprimtaria	Afati
1	Përcaktimi i temës së projektit në bashkëpunim me nxënësit pas propozimit të disa temave Hartimi i një liste paraprake të burimeve të informacionit, që do të mbështesë studimin Përcaktimi i detyrave për secilin grup dhe nxënës	Tremujori i parë shtator – dhjetor 2017 Faza e parë
2	Përdorimi nga nxënësit i literaturës mësimore të rekomanduar Takime të vazhdueshme me mësuesin dhe specialistë të fushës për grumbullimin e informacionit të nevojshëm Grumbullimi përfundimtar i të dhënave dhe menaxhimi i informacionit. Fillimi i plotësimit të portofolit të nxënësit me gjetjet kryesore	Tremujori i dytë janar – mars 2018 Faza e dytë
3	Diskutimi në klasë i gjetjeve kryesore, prezantimi. Vetëvlerësimi i punës në grup dhe i punës individuale	Tremujori i tretë prill – qershor 2018 Faza e tretë

duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë; prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive: harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer mendime/ide, duke u konsultuar dhe duke informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme.

Kompetenca personale

Nxënësi, në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, konstaton dhe përpiqet të zbatojë në praktike dhe në jetën e përditshme ligjet e fizikës.

Kompetenca qytetare

Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët: përshkruan me gojë ose me shkrim mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informacioneve në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara si dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë të tyre.

Kompetenca digjitale

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin: përdor mjetet digjitale për të përpunuar, për të krijuar, për të realizuar dhe për të demonstruar punën me projekt.

3. Përshkrimi i projektit:

- Projekti do të realizohet në tri faza sipas tremujorëve përkatës:
- **Tremujori I:** Prezantimi me temën, ndarja në grupe dhe ndarja e temave për çdo grup.
- **Tremujori II:** Studimi dhe përpunimi i materialit të grumbulluar.
- **Tremujori III:** Prezantimi i punës nga çdo grup.

Përgjegjësi dhe produkti	Kompetencat e fushës
Mësuesi dhe nxënësit Produkti: Hartimi dhe dorëzimi i dokumentit që pasqyron: temën e grupit, nënçështjen individuale, burimet e informacionit ku do mbështetet dhe hapat për fazat pasardhëse	Përcakton një dukuri fizike për kërkim dhe hetim Përdor burime informacioni Zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion
Grupet e punës, nxënësit, mësuesit dhe prindërit Produkti: Mbrojtja paraprake e draft prezantimit të projektit: materialet e mbledhura, foto, video, gjetjet fillestare etj.	Zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion Përcakton ato veprimtari nga jeta e përditshme që kanë të bëjnë me ligjet e fizikës
Grupet e punës dhe nxënësit, mësuesit dhe nxënësit Produkti: Prezantimi final (fletëpalosje, Power point etj.). Raporti përfundimtar dhe vetëvlerësimi	- Jep shpjegime për dukuritë fizike që ka marrë në shqyrtim

4. Përfituesit: Nxënësit e klasës X

5. Nëntemat për secilin grup

Grupi I: Shpejtësia e lartë shkak i aksidenteve në udhëtim. (Si të zbatojmë ekuacionet e kinematikës në përlogaritjen e shpejtësisë së lëvizjes, kohës së frenimit, distancën deri në frenim dhe gjithë faktorët e tjerë që ndikojnë në të.)

Grupi II: Dinamika, një nga pjesët më të rëndësishme të fizikës. (Çdo anëtar do të argumentojë zbatimet e këtyre forcave: 1. forca e fërkimit, 2. forca e tërheqjes së gjithësisë, 3. pesha e trupit, 4. forca qendërsynuese, 5. forca e fërkimit.)

Grupi III: Zbatimi i ligjeve të statikës dhe baraspeshës në konstruksione të ndryshme objektsh. (Grupet të ndalen në konstruksione urash, ndërtesash të veçanta apo unike në botë.)

Grupi IV: Energjia dhe format e saj. (Grupet të ndalen në shfrytëzimin e llojeve të shumta të energjisë në të mirë të njerëzimit.)

Grupi V: Ligjet e termodinamikës. (Anëtarët e grupit do të përqendrohen në zbatimin në praktikë të izoproceseve, sidomos në zbatimin e parimit të parë dhe të dytë të termodinamikës, në ndërtimin dhe funksionimin e motorit termik.)

6. Mënyra e organizimit

Në periudhën I, çdo nxënës dorëzon një plan pune për veprimtaritë që do të organizojë për çdo detyrë të ngarkuar.

Në periudhën II, çdo nxënës dorëzon punën e plotë të ngarkuar nga lideri i grupit.

Në periudhën III, çdo grup prezanton punën sipas mënyrës që ka zgjedhur.

7. Burimet kryesore të informacionit

- Tekstet mësimore të “Fizika 10”, literaturë për fizikën që ka lidhje me temën si dhe revista shkencore.
- Burime të tjera informacioni si enciklopedi të ndryshme, adresa të ndryshme interneti me fokus fizikën dhe ligjet e saj.
- Biseda me specialistë të fushave të ndryshme ku mund të grumbullohen të dhëna etj.
- Vëzhgime në terren (foto) etj.

8. Produkti i pritshëm i projektit

Raporti përfundimtar, ku pasqyrohen zbatimet e ligjeve të fizikës në të gjitha veprimtaritë tona, duke filluar që nga lëvizjet në udhëtime ose edhe në aktivitetin e përditshëm, forcat dhe qëndrueshmëria, termodinamika etj.

9. Mjetet

- Laptop dhe video projektor
- DVD
- Postera dhe materiale të tjera ndihmëse

FUSHA: TEKNOLOGJI DHE TIK

Model portofoli – Periudha e parë

Lënda: TIK

Punoi: Vera Kana, mësuese

Nr.	Rubrika/Detyra	Rezultatet e të nxënit që synohen të arrihen	Pikët
1	Detyra I Detyrë hulumtuese 1. “Çfarë është <i>JavaScript</i> ? Karakteristikat, përdorimet dhe si ndërthuret me HTML-në” ose 2. “Çfarë është <i>Visual Basic</i> ? Karakteristikat dhe përdorimet.”	Nxënësi/Nxënësja: 1. Koncepton programet <i>JavaScript</i> dhe <i>Visual Basic</i> . 2. Thellon njohuritë mbi karakteristikat dhe përdorimet e dy programeve. 3. Organizon qartë/saktë me shkrim mendimet dhe opinionet e tij. 4. Përdor programin kompjuterik Microsoft Word për përpunimin e të dhënave.	10
2	Detyra II Punë praktike “Krijimi i një formulari në <i>JavaScript</i> ”.	Nxënësi/Nxënësja: 1. Koncepton etiketat e duhura për ndërtimin e formularit. 2. Shkruan saktë kodin në <i>Notepad</i> . 3. Printon (me print screen në Word) kodin në <i>Notepad</i> dhe paraqitjen në Html.	10
3	Detyra III Projekti “ <i>Studimi i një BDH-je</i> ” (Faza II)	Nxënësi/Nxënësja: 1. Paraqet punën e bërë gjatë kësaj faze të projektit. 2. Diskuton me grupet e punës mbi kërkimet e kryera, informacionin e grumbulluar nëse është në përputhje me temën, si është bërë përzgjedhja dhe përpunimi i tij nga secili grup. Diskutimi mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës i ndihmon ata të përfitojnë ide nga sugjerimet e njëri - tjetrit. 3. Çdo nxënës dorëzon produktin e punës së tij sipas detyrës së përcaktuar brenda grupit.	15

Vlerësimi i portofolit:

Detyra 1

Nr.	Kriteret	Pikët (10)
1	Estetika e prezantimit dhe e punimit	10
2	Origjinaliteti	2
3	Argumentimi dhe përpunimi i informacionit	2
4	Respektimi i afatit kohor	5

Detyra 2

Nr.	Kriteret	Pikët (10)
1	Estetika e prezantimit dhe e punimit	2
2	Origjinaliteti	2
3	Saktësia shkencore dhe gjuhësore	5
4	Respektimi i afatit kohor	1

Detyra 3

Nr.	Kriteret	Pikët (15)
1	Respektimi i tematikës	4
2	Menaxhimi i informacionit	4
3	Saktësia shkencore dhe gjuhësore	6
4	Respektimi i afatit kohor	1

	Niveli I	Niveli II	Niveli III	Niveli IV			
Pikë	0 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 22	23 - 27	28 - 31	32 - 35
Nota	4	5	6	7	8	9	10



LITERATURA

Korniza Kurrikulare e Shqipërisë, Tiranë, 2014, MAS.

Kurrikula bërthamë për arsimin fillor, arsimin e mesëm të lartë. 2014, IZHA, Tiranë.

Korniza e vlerësimit në arsimin parauniversitar, 2015, IZHA, Tiranë.

Nivelet e arritjeve për shkallën 5 dhe 6. 2016, IZHA, Tiranë.

Udhëzim nr. 14, dt. 28.07.2016, *“Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”*.

Vlerësimi i nxënësit: Manual për mësuesin, IKT, 2009, Tiranë.

<https://utah.instructure.com/courses/202492/pages/what-to-include-in-your-learning-portfolio>

